Përgatitur nga:
Z. Kliti Ceca, Zëvendësdrejtor, Departamenti Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, Banka e Shqiperisë.

Komente për referatin:
"Roli i dërgesave të emigrantëve në zhvillimet social – ekonomike të vendit", Z.Ilir Gëdeshi, Zj. Esmeralda Uruçi

Rëndësia e dërgesave nga emigrantët në zhvillimin ekonomik.

Në raportin e Bankës Botërore "Global Development Finance 2003", të muajit prill 2003, nënvizohet përfundimi se investimet e huaja direkte (FDI) dhe remitancat janë shdërruar në burimet më të rëndësishme finaciare për ecurinë e vendeve në zhvillim, më të rëndësishme se huamarrja private. Ashtu si FDI, remitancat konsiderohen të jenë më të qëndrueshme si burime kapitali dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në një rritje të qëndrueshme në vendet në zhvillim.

Në nivel botëror fluksi i remitancave i kalon 100 usd miliardë për vit, dhe në më shumë se 60 për qind shkon drejt vendeve në zhvillim. Remitancat shpesh vlerësohen më të larta se flukset hyrëse nga tregtia, nga investimet apo nga financimet e huaja. Në këtë mënyrë, ato janë një mekanizm i rëndësishëm në transferimin e burimeve nga vendet e zhvilluara drejt vendeve në zhvillim.

Dy fjalë mbi ecurinë e remitancave në Shqipëri.

Nga mesi i vitit 1990 Shqipëria përjetoi fenomenin e emigracionit masiv, i cili me kalimin e viteve do të bëhej një faktor kyç për financim. Duke filluar që nga viti 1992, ndoshta dhe më herët, gjithnjë e më shumë u bënë domethënëse të ardhurat nga emigrantët.

Në parim, rritja e të hyrave duhet të ndikohet nga pritshmëria për zhvillimet në ekonominë shqiptare. Parashikimet për rritje të nivelit të çmimeve dhe për nënçmim të kursit të këmbimit, të cilat do të shoqëroheshin me nivele më të larta në normën e interesit të lekut, do të nxisnin një hyrje më të madhe të valutës nga emigracioni. Në vitet 1994 - 1996 vihet re fenomeni i dërgesave, tërheqja e të hyrave në valutë brenda vendit nga ana e skemave piramidale, duke arritur nivelin më të lartë në vitin 1996. Vitet 1997 dhe 1999 regjistruan rënie të këtyre transfertave, përkatësisht rezultat i krizës së vitit 1997, me rënien e skemave piramidale dhe i krizës kosovare.



Eksperienca e shkurtër e tranzicionit na tregon se financimi i deficiteve të larta tregtare është jo vetëm financuar nga flukset e kapitaleve, të cilat kanë luajtur pa diskutim një rol të rëndësishëm, por mundësitë e financimit kanë qenë shumë të mëdha brenda vetë llogarisë korente, përmes dërgesave nga emigrantët. Gjatë periudhës 1994 – 2002, në formën e transfertave korente kanë hyrë rreth 4.4 miliardë usd, nga të cilat vlerësohet se rreth 3.6 milardë janë kontribut i emigracionit shqiptar. Dërgesat për vitin 2002 vlerësohen në 632 mln usd ose në 13 për qind të PBB-së.

Teza dhe rekomandime për politikat e administrimit të remitancave.

Natyra, madhësia, frekuenca dhe impakti i të ardhurave nga migrantët në dimensione shoqërore dhe ekonomike të një vendi, është i një rëndësie të veçantë dhe ka tërhequr vëmendjen e studiuesve në të gjithë botën. Flukset hyrëse nga migrantët ndikojnë fuqishëm në të ardhurat dhe në rritjen e standardit të jetesës së vendit përfitues *(Taylor and Wyatt, 1996).* Nga studime dhe matje empirike të bëra, literatura botërore konkludon se në "fazat e para" të migracionit të ardhurat nga migrantët, në masën me të madhe, përdoren si mjet jetese për familjet përfituese, si nevoja për ushqim, veshmbajtje dhe shëndetsore (Massey and Parrado, 1994; Massey et al., 1987; Rhoades, 1978). Me përmbushjen e këtyre nevojave jetësore përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rritja e standardit të jetesës del si prioritet në shpenzimin këtyre flukseve. Në një fazë të mëvonshme, një pjesë e madhe e këtyre dërgesave përdoret për investime frutdhënëse, veçanërisht krijimi i bizneseve të reja, që rezulton me efekt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit, duke ndikuar njëkohësisht në punësim dhe në zvogëlimin e presionit për emigrim. Megjithatë, një fenomen i tillë në Shqipëri është i vogël. Për më tepër, me kalimin e kohës emigrantët dhe brezat pasues, sa vijnë e bëhen me "komplet" në vendin rezident, për rrjedhim lidhja e tyre me vendin e origjinës fillon e zbehet.

Siç theksohet dhe në referat, të ardhurat nga emigrantët shqiptarë tentojnë në një kufi të tillë rënieje.

Emergjenca aktuale qëndron në sigurimin e vazhdimësisë dhe në miradministrimin e këtyre flukseve. Mjetet valutore të krijuara nga puna e emigrantëve, duhet patjetër të ballafaqohen me një politikë të zgjuar brenda vendit. Kjo politikë, përveç kanalizimit të transfertave korente private nga konsumi në investime, duhet të tentojë të krijojë mekanizmat përkatës për të thithur mjetet valutore të gjeneruara nga puna e emigrantëve (pavarësisht nga fakti nëse hyjnë në Shqipëri si transferta apo qëndrojnë si depozita kursimi në shtetet ku ata jetojnë) dhe për të realizuar investime të qëndrueshme.

Rekomandimet tona për politikat e zhvillimit dhe të administrimit të remitancave do t'i fokusonim si më poshtë. Vlen të theksojmë se rekomandimet nisen nga kushti paraprak që remitancat kanë një efekt neto

pozitiv për ekonominë shqiptare. Në stadin aktual jemi të ndëgjegjshëm për ekzistencën e një kushti të tillë.

- ulja e kostove të transfertave.

Rritja e konkurrencës apo shtimi i aktorëve në këtë sektor, do të ulte koston e transfertave. Një çmim i ulët për transfertë do të sjellë rritje të nivelit të këtyre transfertave. Nga ana tjetër, dhe reduktimi i taksave përkatëse do të ndikonte në rritjen e vëllimit të këtyre transfertave.

Me krijimin e një transparence në çmime, qeveria duhet të ushqejë konkurrencën në këtë sektor. Kjo konkurrencë do të çojë jo vetëm në ulje të çmimit por, gjithashtu, do të inkurajojë më shumë migrantë. Transparenca në çmime, si masë e vetme, nuk do të sjellë rënie të çmimeve në një treg të monopolizuar. Qeverisë i duhet të nxisë krijimin e kompanive të tjera për këtë qëllim, si dhe të aplikojë taksa të reduktuara etj.

- krijimi i fondeve të zhvillimit.

Fondet e zhvillimit do të shërbejnë si insitucione që do të grumbullojnë dërgesat nga emigrantët, për të realizuar investime në shuma më të mëdha. Le të kujtojmë këtu shembullin e shoqërive të kursim – kreditit, të cilat janë të zhvilluara në Shqipëri prej disa vitesh. Nga ana tjetër, mendohet që paraja e administruar në këtë mënyrë do të japë efekt në ekonomi dhe në sistemin financiar. Vlen të theksohet që ndërtimi dhe ecuria pozitive në fillim e këtyre fondeve, mendohet të ketë efekte pozitive mbas suksesit të tyre të parë (mbasi emigrantët të binden për efektshmërinë e tyre, mendohet që do të rritet fluksi i të ardhurave të investuara në to). Si shembull mund të merret Korea e Jugut.

- bashkëpunimet midis qeverive.

Duke u mbështetur në eksperiencat e vendeve të tjera, mund dhe duhet të ndërmerren hapa në bashkëpunime midis Qeverisë Shqiptare dhe qeverive të vendeve ku ndodhet emigracioni shqiptar, për ndërtimin e strukturave zyrtare që do të ndihmojnë emigrantët (jo vetëm në problemet e tyre sociale, si legalizimi, shkollimi etj.), në një përdorim eficient të kursimeve të tyre, në drejtim të vendit të tyre. Qeveritë e vendeve pritëse dhe të vendeve të origjinës, duhet të ndërmarrin masa efektive për të lehtësuar investimin nga emigrantët (si për shembull: mikrokreditë, trainimi, lehtësimi i procedurave burokratike, lehtësime fiskale etj.). Për t'u përmendur është rasti i Malit, që ka një emigracion të konsiderueshem në Francë. Strukturat e ngritura nëpërmjet marrëveshjeve qeveritare, kanë ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë së Malit.

- rritja e vëllimit të kredisë.

Mendohet që rritja e veprimtarisë së dhënies së kredisë nga sistemi bankar do të shoqërohet me rritjen e degëve dhe të filialeve të bankave në një shtrirje gjeografike me të gjerë në vend. Kështu dhe shfrytëzimi i sistemit bankar (dhe i institucioneve të tjera financiare) për dërgesat do të ketë rritje.

Matja e remitancave.

Banka e Shqipërisë e vlerëson fluksin e remitancave me anë të një metodologjie, e cila bazohet në teorinë e tregjeve paralele (kjo për arsye se në Shqipëri një pjesë e konsiderueshme e transaksioneve kryhet nëpërmjet këtyre tregjeve). Metodika bazohet në matjen e flukseve dalësë të valutës nga tregu paralel, sepse dërgesat nëpërmjet sistemit bankar janë lehtësisht të matshme. Në këtë mënyrë, kjo metodologji konsiston në ndërtimin e një matrice të flukseve të valutës, e cila evidenton flukset dalëse dhe ato hyrëse të valutes në *cash* nga tregu paralel.

Duhet theksuar se në këtë "thes" të madh të "dërgesave nga emigrantët", përfshihen, përveç dërgesave nga emigrantët edhe mjete valutore të gjeneruara nga aktivitete të dyshimta, të cilat në Shqipëri përfaqësohen nga aktivitete ilegale – të gjitha që sjellin *cash* në Shqipëri.
Vitet e fundit me zhvillimin e sistemit bankar dhe me ndërgjegjësimin e individit për përparësitë e përdorimit të sistemit bankar, dërgesat nga migrantët nëpërmjet sistemit bankar kanë ardhur në rritje.



Konsiderata metodologjike.

Lidhur me metodologjinë që mund të përdoret në vlerësimet e të ardhurave nga emigrantët, mendojmë se mund të ndiqet ajo që propozohet në artikullin e Z. Gëdeshi dhe Zj. Uruçi. Gjithashtu, vlerësojmë që të dhënat e instituteve për këtë qëllim janë të rëndësishme.

Nga ana tjetër, mendojmë se janë të nevojshme vrojtime periodike për të ardhurat nga emigrantët si dhe për të dhëna ekonomiko-sociale për një periudhë kohe, e mbi këtë bazë ngritja e modeleve matematiko-statistikore. Më pas këto modele mund të shërbejnë në gjenerimin e serive kohore (ka shumë metoda për këtë, si Box&Jenkins, Monte – Carlo, AR(p), MA, ARMA, ARIMA etj.). Vrojtime të tjera periodike (më të rralla) duhet të bëhen për korrigjime të mundshme të modelit. Gjithashtu, për të marrë vlerësime sasiore të treguesve, sugjerohet të bëhen vrojtime dhe në vendet pritëse të emigrantëve.